

INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	Mbështetu: Përmirësimi i Mirëqenies Mendore nëpërmjet Teknologjisë dhe Komunitetit
Instrumenti:	Grant i vogël për projekt
Subjekti zbatues:	Qendra për Shëndet Global — QShG
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Dardania, Prishtinë, 10000 organizataqshg@gmail.com +383 45 296 242 https://www.facebook.com/profile.php?id=61551234275996
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/11/2025 Data e përfundimit: 30/06/2026
Buxheti total i grantit (EUR):	6,720.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	6,720.00 EUR
Grupet e synuara:	• Të rinjtë; • Personat me aftësi të kufizuara; • Minoritetet etnike; • LGBTI; • Të moshuarit; • Gratë, veçanërisht ato në rrethana të ndjeshme sociale.
Shtrirja gjeografike:	Në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës
Përmbledhje e grantit:	“Mbështetu” është një ndërhyrje inovative që synon fuqizimin e qasjes në mirëqenie mendore për qytetarët e Kosovës përmes një platforme digjitale funksionale dhe gjithëpërfshirëse. Platforma ekzistuese https://www.shendetimendor.org/ ka ofruar deri më tani ndihmë të parë psikologjike në mënyrë diskrete, profesionale dhe falas, falë angazhimit vullnetar. Me këtë projekt synojmë zhvillimin e mëtejshëm të platformës, duke garantuar cilësi, qëndrueshmëri dhe përfshirje më të gjerë, me fokus te grupet në nevojë. Objektivat përfshijnë: 1. Rritjen e kapaciteteve për ofrimin e ndihmës përmes chat-it nga vullnetarë të trajnuar;

Bashkëfinancuar nga:



	2. Zhvillimin e përmbajtjes edukative në gjuhën shqipe për promovimin e shëndetit mendor; 3. Zgjerimin e qasjes drejt komuniteteve të marginalizuara; dhe 4. Mirëmbajtjen teknike dhe vizuale të platformës. Aktivitetet kryesore përfshijnë trajnimin e stafit, prodhimin e materialeve edukative, operimin e rregullt të chat-it 5 ditë në javë nga 4 orë (20:00–00:00), dhe zhvillimin e një fushate ndërgjegjëse për grupet e marginalizuara. Orari është përcaktuar bazuar në përvojën ekzistuese dhe periudhat kur qytetarët kanë më shumë mundësi të kërkojnë mbështetje jashtë orarit të punës apo shkollës. Ky model siguron balancë mes nevojave dhe kapaciteteve njerëzore e financiare, duke ruajtur cilësinë e mbikëqyrjes profesionale për çdo ndërrim. Projekti zbatohet nga QShG në bashkëpunim me Institutin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës. QShG udhëheq implementimin dhe mbikëqyrjen profesionale; Instituti ofron mbështetje akademike përmes përfshirjes së studentëve, hapësirave për trajnime dhe integritit të platformës në kurrikulën “Shëndeti Mendor Online”.
--	--